

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** PARTIA DEMOKRATIKE DEGA ROSKOVEC

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale , Neni 328 “ Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve”, Neni 328/a “Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike”.

**KUNDER:** [REDAKTUAR] kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

**DREJTUAR:** PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER

*I nderuar Z. Prokuror,*

Bazuar në nenet 280 dhe 283, si dhe neneve 328, dhe 328/a të Kodit Penal, parashtrorjëm këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHEM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dijëni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Çdo person që ka marrë dijëni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*